R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 3180/1 prot. Tiranë, më 04.11.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin *"Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"*

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar email-in tuaj të datës 03.11.2026 nëpërmjet së cilës përcillni për mendim projektvendimin "*Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*" së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit, vlerësojmë pozitivisht parashikimet mbi respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, pasi përpunimi i tyre në "Mekanizmin e Koordinuar të Referimit" përfshin informacion me ndjeshmëri të lartë dhe me pasoja të drejtpërdrejta në sigurinë, dinjitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të personave të përfshirë.

Megjithatë, vlerësojmë të nevojshëm saktësimin dhe plotësimin e disa dispozitave të projektvendimit, me qëllim garantimin e respektimit të parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "Ligji nr.124/2024" .

Konkretisht, ***në pikën 2, të nenit 20 të projektvendimit***, vlerësojmë se togfjalëshi "*pa u kufizuar*" në përcaktimin e burimeve nga të cilat Koordinatori Vendor (KV) merr informacion, krijon hapësirë për një interpretim të gjerë të aksesit në informacion, për këtë arsye sugjerojmë ndryshimin e tij, në respektim të parimit të minimizimit të të dhënave personale.

Në këtë drejtim, sugjerojmë që fjalia hyrëse e ***pikës 2*** në këtë nen të riformulohet me këtë përmbajtje: "*Për këtë qëllim, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë, KV-ja merr informacionin e nevojshëm për menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve, nga:…."*

Në vijim, duke marrë në konsideratë natyrën e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të menaxhimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si dhe nevojën për garantimin e sigurisë së tyre, sugjerojmë që ***pas pikës 6, të nenit 29 të projektvendimit të shtohet një pikë e re***, me këtë përmbajtje: "*Aksesi në të dhënat personale të regjistruara në sistemin REVALB dhe shkëmbimi i informacionit në kuadër të menaxhimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, kufizohet te personat e autorizuar, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duke garantuar zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e këtyre të dhënave, si dhe gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera në sistem. Afatet e ruajtjes së tyre përcaktohen në përputhje me qëllimet e përpunimit dhe legjislacionin në fuqi*."

Gjithashtu, sa i përket ***pikës 7 të nenit 29 të projektvendimi***t, sugjerojmë se marrëveshjet e bashkëpunimit dhe protokollet e shkëmbimit të informacionit duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë qëllimin dhe bazën ligjore të shkëmbimit, kategoritë e të dhënave të subjekteve, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, marrësit e autorizuar, mënyrat e sigurta të transmetimit, kufizimet e aksesit, afatet e ruajtjes, detyrimet e konfidencialitetit dhe procedurat për trajtimin e cenimeve të të dhënave personale.

Këto elemente janë të nevojshme për të siguruar një kuadër të qartë të roleve dhe përgjegjësive të palëve, duke shmangur përpunimin ose aksesin e paautorizuar dhe duke respektuar parashikimet e pikës 3, të nenit 26 të Ligjit nr.124/2024.

Ndërkohë, në tërësi të projektvendimit, sugjerojmë që në nenet në të cilat përdoret fjalët "fshehtësia/fshehtësinë" të zëvendësohen me fjalët "konfidencialiteti /konfidencialitetin", me qëllim unifikimin me terminologjinë e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se me reflektimin e këtyre sugjerimeve, projektvendimi është konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi